



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit\_ dhe nenit 23 paragrafit 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi ..... nga ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

#### **VENDIM**

Procedura për lëndën 12-2538 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit nr. 12-2538/1 me datë 24.04.2019, dorëzuar nga parashtruesi ..... nga .....  
**NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-2538 nga viti 2019, në rastin e lëndës veprohet nga organ tjetër kompetent – PTHP .....

Lënda me numër 12-2538 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetëror, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

#### **Sqarim**

Lënda me numër 12-2538 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2538/1 me datë 24.04.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi ..... nga .....

Në denoncim flitet për akuza kundër personave zyrtar të punësuar në Kadastrën e Komunës ....., për shkak të veprimeve korruptive dhe mos-veprimit për lëndën e dorëzuar nga parashtruesi i fletëparaqitje në vitin 2008. Në shtesë për denoncimin, është dorëzuar edhe shtojcë të dokumentacionit në lidhje me akuzat e lëndës kurse kërkohet së Komisioni shtetëror t'i ndihmon parashtruesit që të zgjidhë problemin.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës KSHPK i merr parasyshtë të gjitha akuzat e parashtruesit dhe për shkak të caktimit të gjendjes faktike të plotë për këtë rast të denoncuar KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri tek organet kompetente dhe institucionet. Nga procedura e kryer për caktimin e gjendjes faktike, KSHPK e kaonstatoi me sa vijon:

- Në rastin e lëndës bëhet fjalë për akuza në lidhje me lëndë të parashtruar nga ana e parashtruesit deri në njësinë rajonale të Kadastrës ..... me datë 05.05.2008, të cilit është duhur t'i shënohet Vendim të miratuar nga Qeveria e RM me datë 22.04.2008, miratuar në bazë të zbatimit të nenit 16 nga Ligji për toka bujqësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 135/07) dhe dhënë me kërkesë të tij, për shkëmbim të tokës bujqësore në pronësi të ish-pronarit – babai i tij të cilën ai e ka trashëguar me tokë bujqësore në pronësi të RM, me të drejtë pronësie me "shkëmbim të parcelave".

- Nga kontrollimi i bërë në ligjet relevante, në përputhje me dispozitën e theksuar ligjore me të cilën është rregulluar shkëmbimi i tokës bujqësore "Për shkak të rritjes së parcelave bujqësore, toka bujqësore në proësi të shtetit mund të shkëmbehet me tokë bujqësore në pronësi private. Shkëmbimi mund të bëhet vetëm kur parcela në pronës private e cila është objekt i shkëmbimit kufizohet me parcelën në pronësi shtetërore. Me përjashtim me vendimit të plotfuqishëm për denacionalizim, shkëmbim mund të bëhet edhe me parcela të cilat mes veti nuk kufizohen. Procedura për shkëmbim të tokës bujqësore e realizon Ministria pas kërkesës së personit të interesuar ose nëpërmjet detyrës zyrtare".
- Në lidhje me rastin e lëndës, nga ana e avokatit të autorizuar nga parashtruesi i denoncimit është vulosur dhe procedura gjyqësore pas ankesës së dorëzuar në aktin e prokurorisë parashtruar nga ana e Prokurosirë themelore publike ..... kundër parashtruesit të denoncimit, për veprë të kryer penale "falcifikim të dokumentit" nga Kodi penal, në të cilën nga ana e Gjykatës themelore ..... është miratuar Vendim me nr ...../09, me të cilën gjykata miraton Vendim me të cilën e kthen aktin e prokurorisë KO nr. ..../09 me datë 27.04.2009 në PTHP ..... dhe e obligon prokurorin themelor publik që në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të vendimit të parshtron propozim deri tek gjykatësi hetues në Gjykatën themelore ..... për realizim të hulumtiit. Në sqarimin e vendimeve gjysore të miratuara, me të cilën bëhet të plotfuqishme me datë 15.09.2009, është theksuar se në rastin e lëndës nuk është bërë hetim dhe nuk është ndëgjuar i akuzuari, dhe nga dëshmitë e ofruara nuk mund të caktohet baza e aktit të prokurorisë, veçanërisht për arsye që në rastin nuk është punuar për dëshmi direkte por për shënime të ndërsjellta ndërmjet më tepër organeve shtetërore.

Parashtruesi i denoncimit dyshon në ligjësinë e vendimit gjysor të miratuar, për arsye se nuk i është dorëzuar nga ana e avokatit të tij, prandaj rastin e ka denoncuar në Prokurorinë e lartë publike në ..... dhe nga aty ka marrë vendimin e lëndës. Pas kësaj, sipas akuzave të parashtruesit, në parcelat në të cilat i është shënuar e drejta për pronësi në bazë të vendimit për shkëmbim, qëllimisht është bërë ndërhyrje nga ana e personave pa të drejtë juridike ( ndërmarrja ..... ) me fletë-pronësi të lëshuar nga Kadastra me çka ai ka paraqitur në MBP-SPM ..... të cilët kanë vepruar pas denoncimit të tij, kan dalë në inspektim në vend-ngjarje dhe kan përgaditur material zyrtar, kurse për veprimin e tyre e kanë lajmëruar me datë 26.04.2016.

- Me datë 26.06.2020, me kërkesë të KSHPK, ka arritur përgjigje nga Njësia për patundshmëri ....., me të cilën dorëzohen vërtetime për rishikim të historiatit për shënimet e bëra për parcelat kadastrale të lëndë. Nga kontrollimi i bërë në vërtetimet e dorëzuara është konstatuar se as parashtruesi as babai itij (..... dhe ..... ) nuk janë theksuar si pronarë të ndryshimeve të theksuara në parcelave të lëndës ose të ndonjë pjese të tyre, vendim i Qeverisë së RM miratuar me datë 22.04.2008 aspask nuk është i evidentuar, dhe gjithashtu, si pronarë të parcelave të lëndës nuk është theksuar as ndërmarrja dhe pronari i saj, për të cilën parashtruesi thekson se ka bërë ndërhyrje në parcelë pa të drejtë ligjore. Prej këtu, diskutabile është se vallë Vendimi i përmendur nga Qeveria e RM është valid ose për të njëjtin është bërë veprë penale për të cilën është ngritur akt në prokurori nga ana e Prokurorisë themelore publike .....,

kundër parashtruesit të denoncimit, për vepër të kryer penale "falcifikim të dokumentit" nga Kodi penal, dhe për të cilin është vulosur lëndë me numër KO nr. ..../09 me datë 27.04.2009.

- Me kërkesë të KSHPK nga ana e PTHP ..... me datë 02.09.2020, është dorëzuar lajmërim me të cilën informohen se në këtë prokurori publike është dorëzuar kallëzim penal KU nr. ..../09 nga SPM ..... pas të cilës është vepruar dhe është dorëzuar Kërkesë për realizim të hetimit KO nr. ..../09 me datë 07.10.2009 kundër ..... nga ....., për arsye të ekzistimit të dyshimeve për vepër të kryer penale "falcifikim i dokumentit" nga neni 378 paragrafi 3 v.v. me paragrafin 1 nga Kodi penal. Pas realizimit të hulumtimit gjykatësi hetues e ktheu shkresat nga kjo Prokurori me datë 04.12.2009, kurse nga ana e Prokurorisë themelore publike ..... me KO nr. ..../09 është ngritur akt prokurorie me datë 27.04.2009 kundër të akuzuarit ..... për vepër penale "falcifikim i dokumentit" nga neni 378 paragrafi 3 v.v. me paragrafin 3 nga Kodi penal. Nga ane Gjykatës themelore në ..... është marrë verdikt K nr. ..../09 me datë 12.10.2010 me të cilën i akuzuari ..... është shpallur fajtor dhe i është dhënë Dënim me kusht pas të cilës është caktuar dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 muaj kurse njëhokësisht është caktuar se e njëjta nuk do të zbatohet nëse i akuzuari në afat prej 2 vitesh nuk bënë vepër të re penale. (duke pasë parasyshë verdiktin është dhënë me datë 12.10.2010, kjo don të thotë se nga ana e prokurorisë është vepruar pas Vendimit të Gjykatës me datë 12.09.2009 me numër KS. Nr. ..../09 me të cilën e kthen aktin e prokurorisë KO nr. ..../09 me datë 27.04.2009, gjegjësisht pas veprimit të përsëritur dhe vendimmarrjes për lëndën është vendosur për verdiktin e theksuar me datë 12.10.2010)

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në lidhje me rastin konkret nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës për mos-veprim të lëndës nga evidenca kadastrale të Komunës së lëndës, dhe gjithashtu për rastin është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe atë: PTHP ....., e cila duke vepruar për kallëzimet penal dorëzuar nga ana e SPM ..... kundër parashtruesit të denoncimit ....., për arsye të ekzistimit të dyshimeve për vepër penale të kryer "falcifikimi dokumentit", kundër këtij personi është ngritur akt prokurorie, si dhe nga ana e Gjykatës themelore në ..... e cila me datë 12.10.2010 morri verdikt me të cilën personi i akuzuar është shpallur fajtor dhe i është dhënë Dënim me kusht me çka është caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj dhe njëkohësisht është caktuar se e njëjta nuk do të zbatohet nëse i akuzuari në afat prej 2 vite nuk kryen vepër tjetër penale të re. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për këtë lëndë, procedura për të njëjtën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke marrë parasyshë të gjithë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

**Është vendosur me datë 29 dhjetor të vitit 2020, me numër 12-2242/5**

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Punoi: J. C., Këshilltarë

Miratoi: m-r V. G., Anëtari KSHPK

KOMISIONI SHТЕТЁРОРЁ ПЁР  
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska

